

Thirrja është e hapur nga data 05.01.2026 deri me 16.01.2026

TERMAT E REFERENCES

HOTELET/ RESTORANTET TË CILËT OFROJNË SHËRBIME PËR REALIZIMIN E AKTIVITETEVE TË ORGANIZATËS NEVO KONCEPTI.

Organizata	OJQ "NEVO KONCEPTI"
Objektiva	Përshkrimi i menyve për realizimin e aktiviteteve të organizatës Nevo Koncepti.

1. TË DHËNAT MBI ORGANIZATËN

OJQ "Nevo Koncepti" është organizatë joqeveritare e themeluar më 26 Nëntor 2014. Në themelimin e OJQ "Nevo Koncepti" kanë marrë pjesë intelektualë të komunitetit Romë të cilët për shumë vite janë angazhuar në forma të ndryshme dhe kanë kontribuar në fuqizimin dhe avancimin e pozitës së komunitetit Rom në pjesë të ndryshme të Kosovës sikurse në Prizren, Gjakovë, Ferizaj, Pejë, Rahovec, Fushë Kosovë, Suharekë etj.

OJQ "Nevo Koncepti" bashkëpunon me fëmijë, të rinjë dhe familje të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian, me institucionet publike qendrore dhe lokale, organizata të shumta vendore dhe ndërkombëtare, media dhe palë tjera me interes.

Aktualisht OJQ "Nevo Koncepti" është duke zbatuar 4 projekte në fusha të ndryshme të cilat synim themelor kanë fuqizimin dhe përmirësimin e pozitës së komunitetit Romë, Ashkali dhe Egjiptian.

2. Detyrat dhe Përgjegjësit

Mirëpritja e stafit dhe antarëve të cilët do të marrin pjesë në aktivitetin të cilin do të zhvillohet në Hotel/Restorant.

Përgatitja e ushqimit sipas kërkesës,

Salla e konference të jetë e përgaditur sipas kërkesës

Përgatitja e faturave me kohë

3. Afati Kohorë

Kërkesat për realizimin e aktivitetit në Restorant do të njëftohet 2 ditë më heret nga stafi i projektit i cili është paraparë të realizojë aktivitetin në Restorant.

4. REZULTATET E PRITSHME

- Bashkëpunim të mirë në mes të dy palëve,
- Ushqimi dhe pijet të jenë me qmime të njëjta gjatë periudhës së kontratës,
- Përgatitja e ushqimit me kohë dhe i freskët,
- Salla e Konferencave të ketë kushtet të cilat i përmbushë për mbajtjen e aktivitetit.

5. PROCEDURA E APLIKIMIT

Të gjithë të interesuarit duhet t'i dërgojnë këto dokumente:

Kërkesa për ofertë (të jetë e nënshkruar dhe e vulosur)

Oferta

Kopja e regjistrimit të biznesit me numër unik identifikues

Të drejtë aplikimi kanë Restaurantet nga komuna e Prizrenit.

Aplikimi duhet të dërgohet **jo më larg se data 16.01.2026** në prokurim@nevokoncepti.org